



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË  
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE  
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY**

**DEPARTAMENTI I TREGTISË/ DEPARTAMENT TRGOVINE/DEPARTMENT OF TRADE**

**Trade Brief për Tregtinë në Shërbime**

**Janar – Qershor 2017**

**Përgatitur nga: Mirsad Simnica**

**Shqipe Jashari – Sekiraqa**

**Tetor, 2017**

Sektori i shërbimeve është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së çdo vendi. Ai jep një kontribut të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në BPV dhe krijimin e vendeve të punës, dhe siguron inpute të rëndësishme për pjesën tjetër të ekonomisë, duke ndikuar kështu në klimën e përgjithshme të investimeve, që është një përcaktues thelbësor i rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Shërbimet janë inpute kryesore për shumicën e bizneseve të tjera, p.sh. Shërbimet e infrastrukturës si energjia, telekomunikacioni dhe transporti. Shërbime financiare që lehtësojnë transaksionet dhe sigurojnë qasje në financa për investime. Shërbimet shëndetësore dhe arsimore të cilat kontribuojnë në një forcë pune të shëndetshme dhe të trajnuar mirë. Shërbimet ligjore dhe ato kontabël të cilat janë pjesë e kornizës institucionale të nevojshme për të mbështetur një ekonomi të shëndetshme tregu. Këta sektorë të shërbimeve janë pjesë kyçe e klimës së investimeve dhe mund të kenë një ndikim më të madh në ecurinë e përgjithshme të biznesit dhe në nivelin e investimeve, dhe kështu rritjen dhe produktivitetin në ekonomi.

Tregtia në shërbime në Kosovë për periudhën Janar-Qershor 2017 ka arritur në total prej 568.2 milion Euro. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshinë shumën prej 350.1 milion Euro, ndërsa importi shumën prej 218.1 milion Euro. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitiv prej 132.1 milion Euro. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit Janar-Qershor 2016, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 324.8 milion euro, përderisa importi rezultoi me 204.5 dhe bilanci 120.2 milion Euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve. Nga statistikat e mësipërme mund të shihet se kemi një trend pozitiv të rritjes së bilancit të shërbimeve me 11.9 milionë Euro ose 10%.

### **Tregtia në Shërbime / Bilanci Janar-Qershor 2017**

Viti	Eksporti i Shërbimeve	Importi i Shërbimeve	Bilanci
	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>
2017	350.1	218.1	132.1
2016	324.8	204.5	120.2

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Sektorët kryesorë të cilët kontribuan drejt një bilanci tregtar pozitiv për periudhën Janar-Qershor 2017 janë: Udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 241.4 milionë Euro, pasuar nga shërbimet profesionale dhe të biznesit me 31.5 milion Euro, shërbimet e komunikimit (ICT) me 23.5 milionë Euro, shërbimet qeveritare me 17.9 milionë Euro dhe shërbimet e ndërtimit me 3.6 milion Euro.

Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë.

## Eksporti i Shërbimeve / Top Sektorët Janar - Qershor 2017

Viti	2017
	<i>milion euro</i>
Udhëtimi	241.4
Shërbime tjera të biznesit	31.5
Shërbimet kompjuterike, informative dhe te telekomunikimit (ICT)	23.5
Mallra dhe shërbime qeveritare	17.9
Shërbimet e ndërtimit	3.6

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, shërbimet e udhëtimit (turizmit) eksporti i të cilit ka arritur në 219.1 milionë Euro, pasuar nga shërbimet afariste dhe profesionale me 29.6 milionë Euro, shërbimet e komunikimit 21.8 milionë Euro, shërbimet e qeverisë 17.5 milionë Euro dhe shërbimet e ndërtimit 5.2 milionë Euro. Duke analizuar këto statistika, mund të shihet se kemi një trend pozitiv të rritjes së eksportit në shërbime. Trendi negativ i tregtisë në shërbime (sa i përket bilancit të shërbimeve) duke se çdo vit e përfshinë një prej sektorëve kryesor: transportin me -38.7 milion Euro dhe shërbimet pensionale dhe te sigurimit -11.8 milion. (periudha: Janar-Qershor). Të pasurit e një bilanci pozitiv të shërbimeve ka rezultuar në zvogëlimin e deficitit të lartë tregtar në mallra.

### Negociatat e Tregtisë në Shërbime në kuadër të CEFTA-së

Negociatat për Tregtinë në Shërbime janë organizuar në nëntë runde të negociatave deri më tani dhe ishin paraparë të përfundojnë brenda 18 muajve nga sesioni i parë i negociatave që është organizuar në muajin Tetor 2014. Afati i fundit për përfundimin e negociatave pritet të jetë nëntori i vitit 2016.

Rundi i 1	Shërbimet Afariste dhe Profesionale	06.09 2014/Shkup
Raundi 2	Shërbimet Afariste dhe Profesionale	26.02. 2015/Bruksel
Raundi 3	Turizmi, Mjedisi, Shërbimet Rekreative (përveç atyre Audiovizuale)	29-30.06.2015/Moldavi
Rundi 4	Shërbimet e Komunikimit dhe Ndërtimit	17-18.09.2015/Moldavi
Rundi 5	Shërbimet e Distribuimit, Arsimit dhe Shëndetësisë	23.11.2015/Moldavi
Rundi 6	Shërbimet Financiare dhe Transportit	2016/ Mali i ZI
Rundet 7, 8, 9	Rishikimi i sektorëve të zotuar për ndryshime dhe negociata shtesë	2016/Mali i ZI

Rundi i parë i negociatave (Shërbimet Afariste dhe ato Profesionale) është mbajtur më 6 nëntor të vitit 2014 në Shkup të Maqedonisë. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia.

Rundi i dytë i bisedimeve i kryesuar nga Moldavia u mbajt më 26 shkurt të vitit 2015 në Bruksel dhe aty u negociuan shërbimet afariste dhe profesionale ashtu siç ishte planifikuar për dy raundet e para. Rundi i tretë i negociatave është mbajtur më 29 - 30 qershor të vitit 2015 në Moldavi ku janë negociuar Turizmi, Mjedisi dhe Shërbimet Rekreacionale.

Raundi i katërt i negociatave u mbajt më 17-18 shtator ndërsa raundi i pesë i negociatave, po ashtu në Moldavi më 23 nëntor të vitit 2015, ndërsa raundet 6,7,8 dhe 9 të negociatave që përfshijnë (financat, transportin dhe rishishikimin e sektorëve të zotuar për ndryshime dhe negociata shtesë) janë mbajtur në Mal të Zi gjatë vitit 2016. Në të gjitha takimet pjesëmarrës ishin pjesëmarrësit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia. Momentalisht është duke u punuar në aprovimin e Protokollit Shtese 6 për shërbime, ku pas aprovimit dalin obligimet për vendet anëtare të CEFTAs për zbatimin e AP6.

#### TIS Databaza

Lidhur me TIS Databazën dhe zbatimin e saj, është përmirësuar baza e të dhënave e vendosur në MTI për tregtinë e shërbimeve. Baza e të dhënave përmban 6 kategori të fushave të ndryshme si në vijim:

1. Statistikat – import, eksport dhe bilanci tregtar.
2. Legjislacioni.
3. Akterët relevante dhe kontaktet e tyre.
4. Barrierat tregtare.
5. Masat ofensive dhe mbrojtëse.
6. Marrëveshjet tregtare.

TIS databaza është e organizuar në bazë të sektorëve dhe specifikon agjencitë qeveritare përgjegjëse për masat e ndryshme. Baza e të dhënave gjithashtu përmban komente të shkurta mbi çështje të mundshme për masa të caktuara, siç janë kufizimet e qasjes në treg ose dispozitat e mundshme diskriminuese. Baza e të dhënave është një mekanizëm shumë i vlefshëm. Kjo bazë duhet të përmbajë të dhëna duke u bazuar në kategoritë e veçuara, aktivitetet dhe projektet e ndërmarra nga MTI-ja në kontekstin e CEFTA-së dhe MSA-së me një përfshirje involvuese të gjerë të akterëve tjerë relevant si ministritë e linjës, agjensionet dhe sektori privat (odat, shoqatat etj). Megjithatë, baza e të dhënave duhet të plotësohet dhe përditësohet dhe nuk përbën një listë të plotë për çdo masë që përfshihet në kërkesat e Direktivës së Shërbimeve.

## Direktiva e Shërbimeve

Momentalisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me projektin e BE-së është në fazën përfundimtare të rishikimit të legjislacionit vendor se a është në harmoni me Direktivën e BE-së 2006/123/BE. Direktiva e Shërbimeve synon të lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve në vendet tjera anëtare dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare mes vendeve anëtare të BE-së. Meqenëse Direktiva është instrument horizontal që mbulon një fushë të gjerë të shërbimeve, implementimi i saj kërkon kombinim të masave legjislative, organizative dhe praktike. Dispozitat e direktivës në një masë të konsiderueshme bazohen në praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushat e lirisë së themelimit dhe ofrimit të shërbimeve dhe komplimentojnë instrumentet ekzistuese të BE. Direktiva obligon vendet anëtare të krijojnë një „Pikën e Vetme të Kontaktit“ dhe të marrin pjesë në një sistem elektronik të informacionit për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunim në mbikëqyrjen e shërbimeve midis vendeve anëtare. Për Kosovën PVK është shumë e rëndësishme pasi që të gjitha shërbimet për biznes mund të ofrohen përmes Web Portalit që nga marrja e informatave të hapjes së biznesit, marrja e lejeve dhe licencave dhe sektorët potencial për investime direkte. Roli i saj është si një E-commerce portal, por më i gjerë në aspektin e të bërit biznes.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Departamenti i Tregtisë ka hartuar Ligjin për Shërbime i cili transpozon direktivën e BE-së Nr. 2006/123/KE për Shërbimet në tregun e brendshëm. Ligji i ri për Shërbime Nr. 05/L-130 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi në muajin Mars 2017. Nga ky ligj dalin obligime shtesë për harmonizimin e të gjitha akteve ligjore dhe akteve nën-ligjore të Kosovës me këtë ligj. Gjithashtu, është paraparë nxjerrja e akteve nën-ligjore për zbatimin e këtij ligji.

Bazuar në Ligjin për Shërbime 05/L-130 janë hartuar dy udhëzime administrative:

Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Funkionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit dhe ka kaluar konsultimin paraprak dhe konsultimin publik.

Udhëzim Administrativ për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë së Projekt Akteve Normative me Ligjin për Shërbime ka kaluar të gjitha procedurat dhe pritjet të dërgohet në Qeveri.

Ndërsa, sa i përket njohjes së përbashkët të kualifikimeve profesionale me vendet e rajonit janë mbajtur takime të rregullta në dy vitet e fundit. Tanimë është konfirmuar nga vendet anëtare të CEFTA-së hapja e negociatave për njohjen e përbashkët të kualifikimeve profesionale për katër sektorët e përzgjedhur me interes të përbashkët për njohje të kualifikimeve. Sektorët në të cilët pritjet të fillojnë negociatat në fund të vitit 2017 janë: Doktorët, Dentistët, Arkitektët dhe Inxhinierët.